



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 986/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjekteve politike Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dhe Partia e Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në afërsi të QV-së, për raundin e dytë të zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dega në Prishtinë.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga Instituti Demokratik i Kosovës ( KDI) dega në Prishtinë, në të cilën theksohet se në shkollën fillore “ Visar Dodani” në fshatin Varosh të Ferizajit, në qendrën e votimit numër 2509d, ka pasur material propagandues të subjekteve politike LDK, AAK, dhe PDK-së. Ky material ka qenë brenda diametrit 100m nga qendra e votimit. Matriale të LDK dhe AAK kanë qenë të vendosuar në trafostacionin e rrymës në afërsi 30m ( shifër e përafërt), kurse posterët e PDK-se kanë qenë të vendosura në shtyllë elektrike në distancë 50m nga qendra e votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit të KDI ndaj subjekteve politike LDK, AAK dhe PDK nga komuna e Ferizajit. Mirpo pretendimet ankimore të kësaj natyre janë të pabazuara, pasi që nga dëshmitë e ofruara janë të paqarta pasi që nga fotot e ofruara si dëshmi për asnjë moment nuk shihet dhe nuk identifikohet objekti për të cilën pretendon pala ankuese së është qendër e votimit.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 986/2013 më datën 04.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**

***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 ( njëzetekatër ) orë nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

